



Pranuar / Doretuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	31. 08 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedimica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtypja Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	5907	2023	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1013/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1013/2023, të datës 19.07.2023, të parashtruar nga ankuesja _____, me adresë fshati Rimanisht, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr. Prot: 541-2 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1013/2023, e datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesja _____.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Prot: 541-2 i datës 22.06.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses _____ e punësuar sipas Aktit të Emërimit Nr.Ref: SP 2018/20 të datës 10.12.2020 në pozitën *Drejtores e Njësisë së Prokurimit*, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese, me datë 29.12.2022 përmes shkresës me numër Ref.nr:SP-2526/22, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurë disiplinore, mbi bazën e supozimit se e njëjta ka kryer shkelje të rëndë disiplinore, me arsyetimin se sipas raporteve të auditimit është konstatuar se ankuesja në cilësi të zyrtares përgjegjëse të

prokurimit ka nënshkruar Kontratën për "Furnizimin dhe shtypjen e broshurave dhe materialeve tjera për shtypje" në vlerë prej 450.000 eurove, vlerë kjo që është dashur të jetë 45.000 euro, dhe së vlera përkatëse nuk është shënuar me shkronja, ka shpallur me gabime teknike kriteret e tenderimit për Kontratën "Shërbime për strelimin (hostimin), programimin dhe mirëmbajtjen e ëeb faqes së gjykatës" si pasojë e të cilave në gjykatë kishte dorëzuar ankesë më 17 shtator 2021 njeri nga operatorët ekonomik, ka nënshkruar më 7 shtator 2021 Kontratën për "Mbikëqyrjen e projekteve për rinovimin e hyrjes, korridoreve në objektin e gjykatës", në të cilën çmimi i kontratës i shënuar më fjalë kishte qenë gabim dhe nuk përkonte me çmimin e shënuar me numra, dhe se me 26 tetor 2021, ka nënshkruar Kontratën për "Shërbime fotografimi, kornizimi dhe shërbime të xhirimit" në të cilën çmimet e produkteve ishin më të larta sesa çmimet e tregut, dhe rrjedhimisht kjo kontratë tani është në procedurë të shkëputjes.

Komisioni Disiplinor, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesen për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 4 pika 1.2 dhe pika 1.13 të Rregullores Nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës si dhe nenit 3 pika 3.1 a) të Kodit të Etikës të Nëpunësit Civil të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke shqiptuar masën disiplinore "Ndërrimi i zyrës dhe i pozitës dhe transferimi në një vend tjetër pune me detyra dhe me nivel të ngjashëm pune".

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në zbatim të Vendimit Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor, më datë 12.05.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot: 541 përmes të cilit ka bërë sistemimin e ankueses në pozitën Zyrtare për Statistika dhe Përgatitje të Seancave në Departamentin e Regjistrimit të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv.

Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 23.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më datë 22.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot: 541-2 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar me ankesë.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. Prot: 541-2 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më datë 19.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5304/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2013, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuere të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5304/2023 të datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr. ref:219/23 i datës 08.02.2023 i Komisionit Disiplinor i Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Kosovës; Ankesën e datës 14.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Vendimit me Nr. Prot: 517 të datës 05.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. prot: 541 të datës 12.05.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Akt Emërimin e datës 15.05.2023 për ankuesen; Ankesën e datës 23.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. Prot: 541-2 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Organogramin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Formularin për Punësim të ankueses për Drejtor të Njesisë së Prokurimit; Certifikatën me Nr. 20/267 të datës 29.12.2003; Vendimin Ref.:SP-1176/20 të datës 06.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin Ref.:SP-2023-1/18/bo të datës 24.12.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin Ref.:SP-1410/18/bo të datës 14.09.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin Ref.:DANJ-629/11/shb të datës 01.05.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm; Akt Emërimin Nr. Ref: SP 1580/19 të datës 26.08.2019; Akt Emërimin Nr. Ref:SP 1833/11/shb të datës 07.10.2011; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e datës 01.04.2010, 08.06.2008, 08.06.2005, 08.06.2004; Formularin për vlerësimin e kryerjes së punës i datës 21.12.2018; Formularin e vlerësimit të performancës i datës 20.12.2019; Dokument identifikimi i ankueses; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim 2020; Certifikatës Themelore Profesionale për prokurim 2017-2019; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim 2014-2016; Certifikatës Themelore Profesionale për prokurim 2011-2013; Certifikatën e profesionalizimit në prokurim 2010, 2008, 2009; Certifikatën e datës 27.12.2006; Certifikatën për periudhën 16-19.12.2010; Certifikatën për periudhën 05-07.05.2008; Certifikatën për periudhën 12-14.01.2009; Certifikatën për periudhën 17-18.03.2015; Certifikatën për periudhën 20-23.04.2011; Certifikatën për periudhën 16-23.03.2007; Certifikatën e datës 13.12.2010, 04.02.2011; Konkurs i Brendshëm i datës 26.10.2020 për pozitën Drejtor i Njesisë së Prokurimit; Akt Emërimin Nr. Ref: SP 2108/20 i datës 10.12.2020; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Shpërndarës i Postës/shofer i datës 24.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve i miratuar më datë 06.09.2021 dhe ndryshuar më datë 03.5.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Procesmbajtës e miratuar me datës 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Redaktor/lektor për gjuhë serbe miratuar me datës 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Redaktor/lektor për gjuhë shqipe miratuar me datës 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Përkthyes nga shqipja në serbisht dhe anasjelltas miratuar më datë 03.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Specialist i Shërbimeve Gjuhësore miratuar më datë 06.09.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Logjistikë miratuar me datë 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Bibliotekës miratuar më datë 16.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Trajnime dhe Zhvillim të karrierës miratuar më datë 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për Zyrtar për Arkiv i miratuar më datës 06.12.2013 dhe ndryshuar më datë 15.12.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Statistike dhe përgatitje të seancave miratuar me datës 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Zyrtar për regjistrimin e lëndëve në DRLSA miratuar më datë 06.12.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Zyrtar Ligjor në Zyrën e

Sekretarit të Përgjithshëm i miratuar më datë 06.11.2013; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Menaxher i Koordinimit për Përkthime miratuar më datë 20.10.2015.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, konstatoi së pretendimet ankimore të ankueses janë të **pabazuara**, sepse:

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi me Nr. Prot: 541-2 i datës 22.06.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është nxjerrë me shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2013, Ligjit Nr.5/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Duke shtuar se Vendimi me Nr. prot: 541 i datës 12.05.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në përmbajtje është degradim në pozitë në krahasim me pozitën që kam mbajtur.

Fillimisht në kuptim të vërtetimit të pranueshmerisë së ankesës Kolegji, i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj,* dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton se ankesa A.nr.1013/2023 është e pranueshme, ngase ankuesja ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë dhe se ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin e çështjes sipas ankesës më numër A.nr.1013/2021, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e ankesës së ankueses të datës 01.06.2023 sa i përket masës disiplinore të shqiptuar sipas Vendimit Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës përmes Vendimit A.nr.801/2023 të datës 28.07.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 01.06.2023 duke e vërtetuar edhe vendimin për shqiptimin e masës disiplinore.

Sa i përket kësaj lënde, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë ankuesi është sistemuar në një pozitë tjetër, ka vlerësuar pozitat e lira brenda për brenda Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe nga kjo rrjedhë se pozitat e lira janë: *Menaxher i Koordinimit për Përkthime, Zyrtar për Protokoll, Zyrtar Ligjor në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, Zyrtar për Regjistrinin e Lëndëve, Zyrtar për Statistika dhe Përgatitje të Seancave, Zyrtar për Prokurim, Zyrtar për web faqe dhe Multimedia dhe Redaktor/lektor për gjuhën serbe.* Nisur nga këto pozita Kolegji i Këshillit ka analizuar të gjitha përshkrimet e këtyre pozitave duke i shqyrtuar me kujdes kualifikimet minimale dhe përvojën e



përgjithshme dhe mi bazë të tyre konstaton se sipas përshkrimit të detyrave të punës për pozitën *Menaxher i Koordinimit për Përkthime* si kualifikime dhe shkathtësi kërkohen: *Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e përkthimeve; Diplomë Universitare, minimum 5 vjet përvojë pune profesionale; Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, serbe dhe angleze*, si rrjedhojë në bazë të dosjes së ankueses e njëjta nuk plotëson kriteret për të ushtruar këtë pozitë, në bazë të përshkrimit të detyrave të punës për pozitën *Zyrtar për Protokoll, Zyrtar Ligjor* në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, *Redaktor/lektor për gjuhën serbe dhe Zyrtar për web faqe dhe Multimedia*, Kolegji i Këshillit, konstaton se përgatitja profesionale që kërkohet për këto pozita nuk përkon me përgatitjen profesionale të studimeve që ankuesja ka, rrjedhimisht as për këto pozita ankuesja nuk ka plotësuar kushtet. Sa i përket pozitës *Zyrtar për Prokurim*, ankuesja nuk ka mund të sistemohet në këtë pozitë, ngase kjo pozitë është pjesë e Zyrës apo Njesisë në të cilën ankuesja ka qenë duke punuar, respektivisht e sistemimi në këtë pozitë do të ishte në kundërshtim me vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sipas Vendimit Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023.

Lidhur me përshkrimin e punës për pozitën *Zyrtar për Regjistrimin e Lëndëve në DRLSA dhe Zyrtar për Statistike dhe Përgatitje Seancave* janë dy pozitat me të përafërta me përgatitjen profesionale të ankueses, rrjedhimisht janë edhe dy pozitat e lira që ankuesja ka mundur të sistemohet si rezultat i Vendimit Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses po ashtu edhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të kontestuar me ankesë, respektivisht Vendimit me Nr. Prot: 541-2 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Vendimi me Nr. prot: 541 i datës 12.05.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, konstaton se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. prot: 541 të datës 12.05.2023 përmes të cilit ankuesen e ka sistemuar në pozitën *Zyrtar për Statistika dhe Përgatitje të Seancave*, ka vepruar në përputhje me Vendimin Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në përputhje me gjendjen faktike respektivisht pozitave të lira brenda institucionit dhe në përputhje me Rregulloren Nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankesave në Gjykatën Kushtetuese, kështu që pretendimet e ankueses sa i përket këtij vendimi janë të pabazuara. Ndërlidhur me pretendimin ankimore të ankueses ndaj Vendimit me Nr. Prot: 541-2 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, duke zbatuar në këtë mënyrë drejtë ligjin material, kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuara, ngase të dyja vendimet janë në përputhje me nenin 48 të Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1013/2023, datë 31/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

